



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË  
FIER****RAPORT VJETOR 2019****I nderuar Z. Prokuror I Përgjithshëm,**

Në përmbushje të nenit 50 i ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë” dhe Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 163, datë 24.01.2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, i paraqet Prokurorit të Përgjithshëm, Raportin Vjetor mbi ecurinë e punës në këtë prokurori për vitin 2019.

Nëpërmjet këtij raporti do të pasqyrohet informacion i detajuar në lidhje me zbatimin e Rezolutës "Per vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2018" miratuar me datë 20.06.2019 nga Kuvendi i Shqipërisë, Rekomandimeve Prioritare "Në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019", të Këshillit të Ministrave Nr.296, datë 10.05.2019, zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, si edhe mënyrën e veprimit të Drejtuesit të Prokurorisë në zbatim të tyre, veprimtarinë e prokurorisë në kuadër të zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur si edhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Gjatë vitit 2019 Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, kanë ushtruar funksionet e tyre në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve procedurale dhe ligjeve materiale në fuqi, akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, me qëllim respektimin e procesit të rregullt ligjor dhe të Drejtat e Njeriut.

Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore janë ndihmuar në punën e tyre nga punonjësit e administratës së Prokurorisë Fier, në respektim të Kodit të Etikës, si dhe në zbatim të Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, duke treguar më shumë profesionalizëm dhe efikasitet në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Funksionet e prokurorit për vitin 2019, kanë vazhduar të ushtrohen duke u fokusuar dhe respektuar “pavarësinë e brendshme të çdo prokurori për hetimin dhe ndjekjen penale”. Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë nxjerrë Udhëzime të Përgjithshme në kuadër të zbatimit të ligjit, apo zbatimit të Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, me qëllim unifikimin e praktikave ligjore të ndryshme, por pa cenuar në asnjë rast “pavarësinë e prokurorit të çështjes”. Gjithë prokurorët janë fokusuar në kryejën e funksionit në ushtrimin e ndjekjes penale dhe për të rikthyer besimin e publikut te drejtësia, ku forca e ligjit vlen për të gjithë në mënyrë të barabartë, në përmbushje dhe respekt të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në punën e përditshme prokurorët kanë aplikuar institutet e reja, të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, si më shpesh gjykimi i drejtpërdrejtë dhe më pak urdhëri penal, gjykimi me marrëveshje, etj. Gjithë trupa e prokurorëve ka bërë perpjekje për një përfaqësim sa më cilësor në këto gjykime. Në lidhje me aplikimin e gjykimit me marrëveshje, si dhe të urdhërit penal, rastet e aplikimit nuk kanë qenë në nivelin e pritshëm, por në gjithë rastet e paraqitura në gjykatë janë pranuar nga ana e Gjykatës të Shkallës së Parë Fier.

Si drejtues I kam kushtuar vëmendje të veçantë respektimit të Kodit të Etikës nga çdo prokuror gjatë ushtrimit të funksionit. Kam mbikqyrur jo vetëm paraqitjen në seancë gjyqësore, në datën dhe orën e caktuar, por dhe mënyrën e komunikimit me trupin gjykues dhe palët në proces, paraqitjen e jashtme dinjitoze, respektimin e disiplinës në punë, garantimit e të drejtave të viktimës së veprës penale, kthimit përgjigje cdo qytetari apo të treti që ka kërkuar informacion, ku për realizimin e pritshmërive falenderoj të gjithë kolegët.

Në funksion të përmbushjes së detyrave, rol të rëndësishëm luan dhe administrata e prokurorisë e cila bën të mundur përgatitjen e materialeve dhe praktikave të dosjeve për në gjykatë, si dhe përmbush një sërë detyrash të tjera që lidhen me punën e prokurorit, cfarë ka mundësuar realizimin dhe përmbushjen në kohë të detyrave të prokurorisë .

Qëllimi kryesor i analizës vjetore të punës, është që të evidentojë të gjitha momentet pozitive dhe problematikat në punën e Prokurorisë Fier për vitin që kaloi, në mënyrë që në vitin në vazhdim të përmirësohen këto tregues, duke synuar për rezultate edhe më të mira.

Ngarkesa që kanë përballuar në punë për këtë vit, treguesit e shënuar në të gjitha drejtimet, lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin në gjykim, vënien në ekzekutim të vendimeve gjyqësore, mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe ushtrimin e detyrave të tjera të ngarkuara me ligj, janë treguas për punë me ndenjë përgjegjësie, nga të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe administrata e kësaj prokurorie. Rritja e cilësisë së hetimit, shkurtimi i afateve hetimore, zbatimi i instituteve të reja procedurale të së drejtës, unifikimi i praktikave, për çështje që nga pikëpamja e kualifikimit ligjor kanë gjetur zgjidhje të ndryshme në praktikën gjyqësore etj, na bëjnë që të synojmë përmirësimin e këtyre treguesve në vitin në vazhdim.

Në vijim paraqesim treguesit e punës për vitin 2019:

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT VJETOR

### **I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT:**

- Respektimi i të drejtave të njeriut;
- Të miturit dhe grupet vulnerabel, si të pandehur dhe viktima.
- Bashkëpunimi ndërinstytucional.
- Bashkëpunimin ndërkombëtar.
- Përdorimin e metodave speciale hetimore dhe hetimet proaktive.
- Informacion mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Informacion mbi zbatimin e rezolutes së Kuvendit dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj.
- Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre.
- Informacion statistikor mbi çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrijnë Funksione Publike.
- Të dhënat për temat dhe numrin e trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore apo të përbashkëta me Policinë e Shtetit.
- Problematikat e hasura.

### **II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË:**

- Volumi i punës në hetim.
- Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale.
- Treguesit kryesor të punës së prokurorisë.
- Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit.
- Çështje të përfaqësuara në gjykatë.
- Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.
- Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative në kompetencë të prokurorisë.
- Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre dhe kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime – kundërvajtje).

**III. TREGUESIT STATISTIKORE 2 VJEÇAR TË VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL:**

**IV. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË:**

- Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve.
- Të dhëna për gjykimet e posaçme.
- Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve.
- Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit.
- Të dhëna për të pandehurit e mitur.

**V. TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA:**

- Ekstradime.
- Letërporositë.
- Njohjet e vendimeve penale.
- Transferimet e procedimeve penale.
- Transferimet e personave të dënuar.
- Shpalljet në kërkim ndërkombëtar dhe heqjet nga kërkimi.

**VI. TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS:**

**VII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË:**

- Zbatimi i buxhetit, marrëdhëniet me median dhe publikun, etj.

**VIII. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2019 DHE REKOMANDIME.**

## **I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2019**

### **• RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT**

Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier gjatë vitit 2019 i kanë ushtruar funksionet e tyre duke i kushtuar rëndësi të veçantë garantimit dhe respektimit të të drejtave themelore të njeriut, duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, në mbrojtje të të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme të viktimave dhe dëshmitarëve, ashtu edhe të të dyshuarve, personave nën hetim, të pandehurve dhe të dënuarve.

Kodi i procedurës penale i ka dhënë statusin e subjektit të procedimit penal viktimës së veprës penale. Në këtë aspekt respektimi i të drejtave të viktimave të krimit në përgjithësi, dhunës në familje, dhunës seksuale, ndihma ndaj personave me aftësi të kufizuara kur janë pjesëmarrës në procedim, etj, kërkojnë angazhim dhe rritje të profesionalizimit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore që merren me çështje penale të kësaj natyre.

Prokurori, Oficeri i Policisë Gjyqësore dhe personeli i prokurorisë kanë mbajtur në vëmendje veçanërisht nevojën për privatësi të viktimave dhe dëshmitarëve veçanërisht në çështjet penale me të mitur.

Gjatë veprimtarisë së përditshme prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë vepruar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën për të Drejtat Themelore të Njeriut, si dhe ligje të tjera që garantojnë këto të drejta.

Gjatë vitit 2019 nuk ka patur, nuk janë evidentuar raste të shkeljes apo cënimit të këtyre të drejtave.

Gjatë të gjithave fazave të procesit penal janë respektuar të gjitha detyrimet proceduriale dhe ato që kanë lidhje me të drejtat e njeriut. Nuk ka patur zgjatje të pajustificuara të hetimit. Janë respektuar dispozitat proceduriale që parashikojnë të drejtat e palëve në procesin penal. Janë marrë në shqyrtim dhe janë vlerësuar kërkesat apo memot e bëra me shkrim që palët kanë paraqitur gjatë hetimit paraprak.

Për Prokurorinë Fier gjatë vitit 2019 nuk ka patur raste pretendimi për diskriminim si dhe nuk ka patur ndonjë Rekomandim të bërë nga Avokati i Popullit për vitin 2019. Gjatë ushtrimit të funksioneve për vitin 2019 Prokuroria Fier ka përmbushur detyrimin ligjor dukëdhënë në kohë informacion për sa është kërkuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, si dhe cdo institucion tjetër apo person i tretë i interesuar.

- **TË MITURIT DHE GRUPET VULNERABËL, SI TË PANDEHUR DHE VIKTIMA**

Në zbatim të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier funksionon Seksioni i Hetimit të Çështjeve Penale me të Mitur, I përbërë nga 2 prokurorë dhe 1 oficer i policisë gjyqësore.

Çështjet penale që kanë të bëjnë me të miturit në konflikt me ligjin, me të miturit viktimë dhe/ose dëshmitarë të veprave penale, ndiqen nga prokurorët e këtij seksioni. Çdo veprim procedural i kryer në lidhje me të miturin në konflikt me ligjin, si dhe marrja në pyetje e të miturit viktimë ose dëshmitar është bërë në prani të mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe psikologut. Prokuroria Fier nuk ka në strukturën e saj psikolog.

Në zbatim të rekomandimeve prioritare të KM, Rezolutës të Kuvendit, në qershor është krijuar Sektori i Asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm i përbërë nga një koordinator viktimash. Në këtë Prokurori është përzgjedhur koordinatori Eni Begaj, e cila ushtron funksionet e veta në një ambient të veçantë dhe të arregulluar posaçërisht për pritjen e viktimave të veprave penale, në veçanti të të miturve.

Nga Prokuroria Fier i është kushtuar rëndësi specializimit të prokurorëve dhe oficerit të policisë gjyqësore që administrojnë dhe asistojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur, duke mundësuar pjesëmarrjen e tyre në çdo trajtim të organizuar në lidhje me çështjet me të mitur.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier prej muajit Korrit 2019 është krijuar seksioni për të mitur.

Në lidhje me të dhënat për të miturit në konflikt me ligjin dhe viktimë, ju informojmë se, gjatë vitit 2019 janë rregjistruar gjithsej 38-proçedime penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe viktimë/dëshmitarë të mitur, nga të cilat:

- 11 proçedime me autorë të mitur persona në konflikt me ligjin:

1 proçedim penal, neni 290/1- (1autor i mitur),

1 proçedim penal, neni 290/2- (1autor i mitur),

7 proçedim penal, neni 291- (7 autorë të mitur ),

1 proçedim penal, neni 79/1-a(autor i mitur + viktimë e mitur ),

1 proçedim penal, neni 79/c- ( 1autor i mitur + 1 viktimë e mitur),

- 27 proçedime – me viktimë /deshmitarë të mitur.

16 proçedime penale, nenin 130/a/4- (7 viktimë të mitur) ,

2 proçedime penale, nenin124/1- (3 viktimë të mitur),

1 proçedim penal, neni 124/b-1- (1 viktimë e mitur),

1 proçedim penal, neni 79-(1viktimë e mitur),

5 proçedime penale, neni 130/a/1- (5 dëshmitar të mitur),

1 proçedim penal, neni 274- (1dëshmitar i mitur),

1 proçedim penal, neni 121/a-1-( 1 dëshmitar i mitur ).

- Në lidhje me 11 proçedimet penale me të pandehur të mitur nga të cilat ka:

9 proçedime penale të cilat janë me autor të mitur të pandehur për veprat :

7 proçedime penale, neni 291- ( 7 pandehur, 7 gjinia mashkull),

1 proçedim penal, neni 290/1 - ( 1 pandehur , gjinia mashkull),

1 proçedim penal, neni 134/1- ( 1 pandehur, gjinia femër ).

2 proçedime penale të cilat janë me autor të mitur të pandehur për vepra të renda:

1 proçedim ardhur për kompetence lëndore në fazën e gjykimit nga Gjykata e shkallës së parë Vlorë, neni 79/1-a i K.Penal ( me 1 autor të mitur dhe 1 viktimë të mitur, gjinia mashkull)

1 proçedim ardhur për kompetenë nga Prokuroria për Krimet të Rënda Tiranë, neni 79/1-c i K.Penal ( 1 pandehur, dhe 1 viktimë, të mitur, gjinia mashkull)

Nga këto proçedime penale rezultojnë në gjykim:

- 4 proçedime dërguar me kërkesë për gjykim me (4 pandehur të mitur), janë në gjykim.
- Nga këto një proçedim kthyer nga gjykata prokurorit të çështjes (1 pandehur të mitur) me qëllim aplikimin e masës alternative të shmangies.
- çështje ka pëfunduar gjykimi (2 pandehur të mitur) neni 291 i Kodit Penal, dënuar me burgim dhe aplikim dënim alternativ neni 59 i Kodit Penal.
- 1-çështje me të pandehur të mitur ndodhet për gjykim (ardhur për kompetencë lëndore në fazën e gjykimit nga Gjykata e shkallës së parë Vlorë, neni 79/1-a i K.Penal ( me autor të mitur dhe viktimë të mitur, gjinia mashkull)

Ndodhen në hetim paraprak proçedime penale me të mitur:

- proçedime me të mitur në konflikt me ligjin ( 3 autor i mitur ).
- 1 proçedim ( ardhur nga Krimet e Rënda Tiranë, neni 79/1-a K.Penal, i mituri në konflikt me ligjin është nën moshën për përgjegjësi penale dtl.26.11.2008).

Proçedimet penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë /dëshmitarë të mitur për vitin 2019 janë 38 gjithsej: ku përfshihen 11 proçedime me të mitur në konflikt me ligjin dhe të tjerat me viktimë /dëshmitarë të mitur.

Janë derguar për gjykim gjithsej;

- 20 proçedime penale dërguar për gjykim,
- proçedime penale pushuar,
- proçedime penale gjykuar,
- 13 proçedime penale hetim.

Për sa i përket masave alternative të shmangies, për të miturit në konflikt me ligjin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nuk është aplikuar në asnjë rast gjithashtu nuk rezultojnë çështje të pushuara për të cilat të jëtë zbatuar instituti i shmangies.

Në zbatim të rekomandimeve prioritare të KM, Rezolutës të Kuvendit, në Qershor është krijuar Sektorit i Asistences ndaj subjekteve me status të posaçëm i përbërë nga një koordinator viktimash. Në këtë Prokurori është përzgjedhur koordinatori Eni Begaj, e cila ushtron funksionet e veta në një ambient të veçantë dhe të arreduar posaçërisht për pritjen e viktimave të veprave penale, në veçanti të të miturve.

Nga të dhënat statistikore ka rezultuar se vepra penale e kryer më shpesh nga të miturit në konflikt me ligjin është “Drejtimi automjeteve në mënyrë të parregullt”pa leje drejtimi. Në të gjitha rastet të miturit në konflikt me ligjin janë hetuar në gjendje të lirë dhe janë dënuar me dënime alternative.

Konstatojmë se prokurorët që janë të caktuar me hetimin e të miturve nuk kanë aplikuar në asnjë rast masat alternative të parashikuara në nenet 56, 57,58 dhe 62 të Kodit të Drejtësisë Për të mitur. Kjo për shkak të problematikave të shfaqura në lidhje me institucionin ku duhet të kryhet “Raporti i vlerësimit individual” për të miturin në konflikt me ligjin një akt i domodoshëm për aplikimin e masave alternative të sipërcituara, nëse duhet të kryhet nga ekspertë të licencuar nga Ministria e Drejtësisë, Zyra e Shërbimit të Mbrojtjes për fëmijë pranë organeve të pushtetit vendor, Zyra e Shërbimit të Provës, ose Koordinatorin pranë Prokurorisë. Në përfundim, zbatimi i alterantivave të dënimit të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Për të Mitur, mbetet prioritet në punën e prokurorëve të seksionit për të mitur, për vitin 2020. E rendësishme është që trajnimet me tema per Kodin e Drejtësisë për të Mitur duhet të jenë të vazhdueshme.

- **BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL.**

Objektivi kryesor i punës së prokurorisë mbetet rritja e efektivitetit të hetimit dhe vënia përpara përgjegjësisë penale e personave që shkelin ligjin. Përbushja e këtij objektivi varet edhe nga bashkëpunimi me institucionet dhe strukturat e tjera ligjzbatuese.



Në luftën kundër kriminalitetit bashkëpunimi dhe koordinimi është thelbësor në ngritjen e një çështje penale. Për këtë arsye forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional edhe gjatë vitit 2019 për Prokurorinë Fier ka qënë prioritar.

Përgjatë gjithë vitit 2019, janë realizuar takime të përbashkëta, janë shkëmbyer informacione, janë mbajtur raporte korrekte me institucione dhe struktura ligjzbatuese, me të cilat lidhet ngushtë puna e prokurorise, në zbatim të ligjit procedural penal dhe ligjit organik për prokurorinë.

**Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, gjatë vitit 2019, ka patur kryesisht marrëdhënie, por jo vetëm, me:**

- **Prokurorinë e Përgjithshme, me të gjitha drejtoritë e organizuara pranë Prokurorisë Përgjithshme;**
- **Strukturat e Policisë së Shtetit, Drejtorinë Vendore të Policisë Fier dhe Komisiariatet që ushtrojnë funksionet në territorin ku shtrin kompetencat Prokuroria Fier, si dhe Stacionet e Policive;**
- **Me të gjitha institucionet e tjera që kanë organizuar shërbime të policisë gjyqësore, dhe kanë referuar materiale hetimore në Prokurorinë Fier;**
- **Me Gjykatën e Shkallës së Parë Fier, për fazën që lidhet me kërkimet e bëra gjatë hetimit paraprak, në seancë paraprake, me përfaqësimin e akuzës në gjykim, kërkesat në fazën e ekzekutimit etj;**
- **Me Prokurorinë dhe Gjykatën e Apelit Vlorë, për fazen që lidhet me çështjet penale të ankimuara;**
- **Me I.E.V.P - Fier,**
- **Me Zyrën e Shërbimit të Provës;**
- **Me Zyrën e Përmbarimit**
- **Me Institucione të tjera në nivel lokal.**

Konkretishtlidhur me rritjen e bashkëpunimit me policinë gjyqësore në funksionin të përmirësimit të cilësisë së veprimeve hetimore për veprat penale të trafikimit të lëndëve narkotike dhe krimeve të tjera të rënda me ndikim të lartë shoqëror, si dhe forcimin e bashkëpunimit me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe institucioneve kombëtare në funksion të hetimeve proaktive që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit, etj., sqarojmë se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka nënshkruar me Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesatm Memorandumin e Bashkëpunimit “*Për Forcimin e Kapaciteteve të Hetimit*” me nr.77 prot., datë 19.07.2019, me qëllim realizimin e komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave nëpërmjet krijimit të një Task Force me pjesëmarrës përfaqësues të të dyjave institucioneve, forcimin e veprimeve të përbashkëta hetimore për çështjet që lidhen me korrupsionin e zyrtarëve, lëndët narkotike, veprat penale në procesin zgjedhor, veprimet arbitrare dhe tejkalimin e kompetencave të policisë së shtetit gjatë ushtrimit të detyrës. Po ashtu objekt, i këtij memorandumi është koordinimi i punëve dhe realizimi i

analizave të përbashkëta për fillimin e hetimeve, kryerjen e veprimeve hetimore, ndjekjen e rasteve me hetime proaktive.

Duke qenë se janë konstatuar mangesi në lidhje me trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore, për vitin e ri akademik 2019-2020, Shkolla e Magjistraturës ka përfshirë në programin e trajnimit vazhdues edhe trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore pranë sesioneve të prokurorive. Megjithatë trajnimi profesional OPGJ-ve në fushën e hetimeve financiare, evazionit fiskal dhe krimit kibernetik mbetet një sfidë për të ardhmen, duke qenë se prokurorët kanë konstatuar hetime të cekëta dhe joprofesionale nga ana e OPGJ-ve.

Më datë 24.06.2019 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor të Fierit dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë-Prezenca në Shqipëri për *“Zbatimin e Analizës së Sistemit për Bashkërendimin, Koordinimin, Bashkëpunimin dhe Komunikimin midis Policisë Gjyqësore dhe Prokurorisë në Procedimet Penale”*, me qëllim krijimin e një kornize për bashkëpunimin ndërmjet Prezencës dhe Prokurorisë në lidhje me zbatimin e një analize sistemi për bashkërendimin, koordinimin, bashkëpunimin dhe komunikimin midis Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore në procedimet penale.

Përsa i përket forcimit të koordinimit ndërinstitucionale në lidhje me të dhënat statistikore në fushën e veprave penale të pastrimit të parave, në kuadër të raportimeve që lidhen me procesin e integritetit të vendit, sqarojmë se në zbatim të Qarkores së Prokurorit të Përgjithshëm *“Për rritjen e efektivitetit në luftën ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”* dërguar me shkresën nr.2843 prot., datë 25.10.2019, Drejtuesi i Prokurorisë Fier ka nxjerrë Udhëzimin nr.109 datë 31.10.2019 *“Për funksionimin e procesit të plotësimit të regjistrat për pasqyrimin e të dhënave për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal”*. Prokurori i Pikës së Kontaktit është zgjedhur Zëvendës Drejtuesi Ervisa Hyka, e cila ka përpiluar regjistrat e procedimeve penale nga viti 2012 dhe në vijim për nenin 287 të K.Penal, si dhe regjistrin e hetimeve pasurore që ndiqen në bazë të Ligjit Antimafia duke raportuar periodikisht në Prokurorinë e Përgjithshme lidhur me të dhënat statistikore.

#### • **RAPORTET ME PROKURORINË E PËRGJITHSHME.**

Gjatë vitit 2019 ka patur një bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjitha Drejtoritë në Prokurorinë e Përgjithshme, strukturat e tjera të Prokurorisë së Përgjithshme, si Kabineti, Drejtoria Gjyqësore, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Drejtoria e Përgjimeve të Telekomunikimeve dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informatore, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, etj.

Për çdo informacion të kërkuar është dërguar përgjigje brenda afateve të përcaktuara.

Ky bashkëpunim i ka shërbyer shumë punës së përditshme, përmiresimit të parametrave tregues dhe realizimit të objektivit të veprimtarisë në Prokurorinë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë Fier.

Përsa i përket forcimit të koordinimit ndërinstitucionale në lidhje me të dhënat statistikore në fushën e veprave penale të pastrimit të parave, në kuadër të raportimeve që lidhen me procesin e integritetit të vendit, sqarojmë se në zbatim të Qarkores së Prokurorit të Përgjithshëm “Për rritjen e efektivitetit në luftën ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” dërguar me shkresën nr.2843 prot., datë 25.10.2019, Drejtuesi i Prokurorisë Fier ka nxjerrë Udhëzimin nr.109 datë 31.10.2019 “Për funksionimin e procesit të plotësimit të regjistrat për pasqyrimin e të dhënave për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal”. Prokurori i Pikës së Kontaktit është zgjedhur ZëvendësDrejtuesi Ervisa Hyka, e cila ka përpiluar regjistrat e procedimeve penale nga viti 2012 dhe në vijim për nenin 287 të K.Penal, si dhe regjistrin e hetimeve pasurore që ndiqen në bazë të Ligjit Antimafia duke raportuar periodikisht në Prokurorinë e Përgjithshme lidhur me të dhënat statistikore.

Në zbatim të planit të veprimit të marrëveshjes me EUROJUST, dhe në zbatim të Udhëzimit nr.47 datë 14.09.2019 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”, nga Drejtuesi i Prokurorisë me Udhrin nr.72 datë 03.07.2019 është caktuar prokurore Elida Hoxhaj në detyrën e prokurores me shtypin, e cila do të përmbushë detyrimet e prokurorisë në zbatim të nenit 61 të ligjit nr.87 datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjit nr.9887 datë 10.03.2018 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Gjithashtu është caktuar Koordinatorë Eni Begaj, si Koordinatorë për të drejtën e informimit, e cila nën drejtimin e prokurorit të caktuar më sipër dhe nën mbikqyrjen e tij, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e të drejtës së informimit duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, mbrojtjes së të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë konform ligjeve të sipërcituara.

#### • RAPORTET ME STRUKTURAT E POLICISË SË SHTETIT.

Gjatë vitit 2019 bashkëpunimi me të gjitha strukturat e policisë së shtetit, që veprojnë në qarkun e Fierit, si Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Fier, Komisaritet e Policive, në Fier dhe Mallakastër, si dhe Stacionet e Policive respektive, ka qënë mjaft i mirë dhe rezultativ. Në kuadër të këtij bashkëpunimi është mundësuar respektimi me rigorozitet i detyrimeve ligjore në funksion të rritjes së cilësisë dhe shpejtësisë së hetimit paraprak. Janë realizuar takime periodike dhe analiza të përbashkëta me Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera ligjzbatuese, qoftë në nivel drejtuesish institucionesh, qoftë në nivel prokurori me përfaqësues të seksioneve të caktuara. Pjesa më e madhe e procedimeve penale janë regjistruar mbi bazën e materialeve hetimore të referuara nga shërbimet e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit. Si rregull veprimet hetimore, prej prokurorëve të ngarkuar me hetimin e këtyre çështjeve penale, janë deleguar po tek oficerët e policisë gjyqësore, të shërbimeve përkatëse. Në disa raste kur ka patur lëvizje të oficerëve të policisë gjyqësore në detyrë,

apo për oficerë të policisë gjyqësore që ushtrojnë detyrën me kohë të pjeshme, delegimi i veprimeve hetimore është bërë tek oficerët e policisë gjyqësore të Seksionit të Prokurorisë. Pranë Prokurorisë Fier kryejnë funksionin e tyre si oficerë të policisë gjyqësore dhe dy oficerë të D.P.V. Fier. Është rritur cilësia dhe niveli i hetimeve paraprake të kryera nga shërbimet e policisë gjyqësore dhe po kështu është rritur përgjegjshmëria e oficerëve të policisë gjyqësore, në raport me procedimin penal që u delegohet për hetim. Materialet hetimore, me veprime të ngutshme, referohen në kohë. Po kështu ka patur një koordinim të mirë ndërmjet prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, në aspektin e të vepruarit në kohë, në rastet e hetimeve proaktive apo hetimeve që lidhen me asetet kriminale.

Lidhur me rritjen e bashkëpunimit me policinë gjyqësore në funksionin të përmirësimit të cilësisë së veprimeve hetimore lidhur me veprat penale të trafikimit të lëndëve narkotike dhe krimeve të tjera të rënda me ndikim të lartë shoqëror, si dhe forcimin e bashkëpunimit me të gjitha agjencitë ligjzbatuese të institucioneve kombëtare në funksion të hetimeve proaktive që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit, etj., sqarojmë se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka nënshkruar me Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat Memorandumin e Bashkëpunimit “Për Forcimin e Kapaciteteve të Hetimit” me nr.77 prot., datë 19.07.2019, me qëllim realizimin e komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave nëpërmjet krijimit të një Task Force me pjesëmarrës përfaqësues të të dyjave institucioneve, forcimin e veprimeve të përbashkëta hetimore për çështjet që lidhen me korrupsionin e zyrtarëve, lëndët narkotike, veprat penale në procesin zgjedhor, veprimet arbitrare dhe tejkalimin e kompetencave të policisë së shtetit gjatë ushtrimit të detyrës. Po ashtu objekt, i këtij memorandumi është koordinimi i punëve dhe realizimi i analizave të përbashkëta për fillimin e hetimeve, kryerjen e veprimeve hetimore, ndjekjen e rasteve me hetime proaktive.

- **RAPORTET ME GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË FIER**

Raportet me Gjykatën e Shkallës së Parë Fier kanë qënë korrekte dhe ligjore, në të gjitha fazat e përfaqësimit të prokurorisë në gjykim. Këto raporte korrekte dhe ligjore shfaqen si në kërkesat që lidhen me fazën e hetimit paraprak, tek gjyqtari i seancës paraprake, në përfaqësimin e akuzës në gjyq, në gjykimin e procedimeve penale, si dhe në gjykimet ku objekt janë kërkesat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, gjykimet me viktimë akuzuese, letërporosi nga jashtë shtetit etj. Prokurorët kanë respektuar me korrektesë pjesëmarrjen në gjykim, nuk ka patur shtyrje apo zvarritje të pajustificuara të proceseve gjyqësore, me përjashtim të seancave gjyqësore, për të cilat kanë patur përplasje në orar. Nga prokurorët është respektuar solemniteti në gjykim.

- **RAPORTET ME PROKURORINË E APELIT VLORË.**

Me Prokurorinë e Apelit Vlorë ka patur një komunikim të vazhdueshëm dhe shumë të ngushtë si dhe më parë, në funksion të përfaqësimit sa më cilësor të akuzës në çështjet e ankimuara.

Nga ana jone është vazhduar ndjekja e praktikës që apelimet e prokurorëve të shkallës së parë, si për masat e sigurimit dhe për vendimet përfundimtare, krahas depozitimit në gjykatë dërgohen paralelisht për njoftim edhe në Prokurorinë e Apelit, po ashtu edhe njoftimi që Prokuroria e Apelit i dërgon kësaj zyre për vendimet përfundimtare në shkallën e dytë të gjykimit, për çdo tremujor.

Në funksion të këtij qëllimi është edhe organizimi i takimeve periodike, komunikimet nga Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit dhe prokurorët e kësaj prokurorie, me Drejtuesin dhe prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për njohjen dhe trajtimin e problemeve të hasura në çështjet e ankimuara. Ky komunikim ka bërë që të njihemi në kohë me qëndrimet e Gjykatës së Apelit për zgjidhje ligjore ku qëndrimet e trupave gjyqësore në shkallë të parë janë të ndryshme.

Si rezultat i një komunikimi të tillë është bërë e mundur që të njihen dhe trajtohen me mirë problematikat që lidhen me përfaqësimin e akuzës në çështjet e ankimuara si edhe për rastet e paraqitjes së ankimit ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për disponime të ndryshme.

Drejtuesi i prokurorisë së Apelit Vlore ka qënë i vemëndshëm në mbikqyrjen e bazueshmërisë ligjore të ankime të paraqitura nga prokurorët e kësaj prokurorie.

Për këtë arsye ka dërguar vazhdimisht në rrugë zyrtare sygjerime në lidhje me efektivitetin e ushtrimit të ankimit me qëllim shamtien e ankimeve të pabazuara.

Këto sygjerime janë pranuar dhe janë bërë pjesë e praktikës së punës së prokurorëve.

- **RAPORTET ME GJYKATËN E APELIT VLORË.**

Raportet e Prokurorisë Fier me Gjykatën e Apelit Vlorë kanë qënë tËpër të kufizuara, pasi përfaqësimi i akuzës në Gjykatën e Apelit është kryer nga Prokurorët në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

Gjatë vitit 2019 nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë janë dërguar nëpërmjet postës elektronike vendimet gjyqësore me ekzekutim të menjëhershëm të cilat janë ekzekutuar menjëherë nga prokurorët.

- **RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA VENDORE**

Është bashkëpunuar me institucione të tjera vendore, për aq sa ka qënë e nevojshme, si Prefektura Fier, Bashkitë, që gjenden në territorin e Qarkut të Fierit ( Fier, Ballsh, Roskovec, Patos), në aktivitete që i shërbejnë parandalimit të përhapjes së veprave penale, të uljes së kriminalitetit sipas përcaktimeve të Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave për vitin 2019, sikurse janë ato në fushën e kultivimit dhe shpërdarjes së lëndëve narkotike, aksidenteve automobilistike, dhunës në familje etj.

Është bashkëpunuar me I.E.V.Penal Fier, si në aspektin e kryerjes së hetimeve për vepra penale të kryera në ambientet e këtij institucioni ashtu dhe në pjesëmarrjen në aktivitete të organizuara nga ky institucion në kuadër të rehabilitimit të të dënuarve që vuajnë dënimin.

Në zbatim të ndryshimeve ligjore në ligjin Nr.8328, datë 16.04.1998, Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, neni 55, për kalimin e përkohshëm të të paraburgosurit dhe të dënuarit në regjimin e mbikqyrjes së veçantë ,për vitin 2019, nga prokurorët e seksionit të ekzekutimeve janë paraqitur në Gjykatë, 17 kërkesa për vendosje të të dënuarve në regjim të posaçëm. Këto kërkesa janë konfirmuar të gjitha nga Gjykata Fier.

- **BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier gjatë vitit 2019 ka mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Marëdhënieve Juridiksionale me Jashtë ne Prokurorinë e Përgjithshme, në lidhje me shpalljet në kërkim ndërkombëtar, në lidhje me letërporosi të mbërritura nga jashtë shtetit dhe të nisura për jashtë shtetit, ekstradimet, etj. Komunikimi në kohë ka qënë rezultativ duke mosjellë asnjë vonesë apo vështirësi në përmbushje të veprimeve proceduriale të kërkuara.

Më datë 24.06.2019 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor të Fierit dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë-Prezenca në Shqipëri për *“Zbatimin e Analizës së Sistemit për Bashkërendimin, Koordinimin, Bashkëpunimin dhe Komunikimin midis Policisë Gjyqësore dhe Prokurorisë në Proçedimet Penale”*, me qëllim krijimin e një kornize për bashkëpunimin ndërmjet Prezencës dhe Prokurorisë në lidhje me zbatimin e një analize sistemi për bashkërendimin, koordinimin, bashkëpunimin dhe komunikimin midis Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore në proçedimet penale.

- **PËRDORIMI I METODAVE SPECIALE TË HETIMIT DHE HETIMET PROAKTIVE.**

Në luftën kundër kriminalitetit, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier është angazhuar maksimalisht në përdorimin e metodave speciale hetimore dhe kryerjen e hetimeve proaktive, duke bashkëpunuar me të gjithë institucionet e tjera ligjzbatuese me qëllim ashpërsimin e luftës kundër kriminalitetit.

Gjatë hetimit të veprave penale si korrupsioni, krime kundër jetës, të kryera me dashje etj, nga prokurorët janë përdorur metoda speciale të hetimit si përgjimi telefonik dhe ambiental, vëzhgimi etj.

Përgjithësisht në këtë drejtim ka patur përmirësim në koordinimin ndërmjet oficerëve të policisë gjyqësore pikë kontakti në çështje konkrete me oficerët e policisë gjyqësore që realizojnë përgjimet, duke mundësuar që informacioni të dërgohet në kohë tek grupet e vëzhgimit apo prokurori, të cilat kanë bërë të mundur dokumentimin dhe realizimin e flagrancës për çështje penale në fushën e narkotikëve. Është e rëndësishme që në këtë drejtim të punohet më shumë dhe më mirë duke shtuar burimet njerezore nga ana e strukturave të policisë vendore, me qëllim dokumentimin e disa fenomeneve problematike në qytetin tonë, të cilat do kenë vëmendjen tonë në vazhdim për këtë vit.

- **INFORMACION MBI ZBATIMIN E UDHËZIMEVE TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM.**

Zbatimi i ligjeve për organizimin dhe funksionimit të prokurorisë në Republikën e Shqipërisë si edhe ligjet e tjera të reformës në drejtësi të miratuara gjatë viteve 2016 - 2017, është ndihmuar nga udhëzimet të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.

Udhëzimet e Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm na kanë ndihmuar në punën tone të përditshme. Këto Udhëzime i kanë shërbyer zbatimit uniform të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, si dhe kanë qenë një ndihmë për të unifikuar zbatimin e ligjit, duke patur në konsideratë faktin që në një sërë ligjesh që zbatohen në punën e përditshme të prokurorit ka patur ndryshime të karakterit thelbësor.

Këto Udhëzime kanë kontribuar në forcimin e ligjshmërisë dhe efektivitetit të punës së përditshme të prokurorëve. Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore kanë vepruar në përputhje me sa udhëzohet në Udhëzimet e Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.

Përgjithësisht Udhëzimet e Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm janë zbatuar drejtperdrejti, por për disa prej tyre, me qëllim zbatimin e tyre në përputhje me burimet dhe kapacitetet e Prokurorisë Fier, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier janë nxjerrë udhëzime të përgjithshme të brendshme.

Drejtuesi i Prokurorisë Fier ka nxjerrë udhëzime të përgjithshme të tjera, në zbatim të ligjit.

- **INFORMACION MBI ZBATIMIN E REZOLUTËS SË KUVENDIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT NË ZBATIM TË SAJ.**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier gjatë vitit 2019 ka vlerësuar dhe punuar me qëllim zbatimin e Rezolutes së Kuvendit të Shqipërisë “Per vleresimin e veprimtarise se organit të prokurorisë për vitin 2019”, si dhe “Planit të veprimit”, të nxjerrë në zbatim të kësaj rezolute.

Ka rritje të numrit të hetimeve proaktive në veçanti në lidhje me veprat penale kundër narkotikëve. Gjatë vitit 2019 ka patur rritje të hetimeve pasurore, kryesisht në lidhje me nenin 287 të K.Penal, të cilave u janë shtuar edhe referimet pasurore në kuadër të ligjit Antimafia.

Është dërguar në kohë informacioni i kërkuar për subjektet e rivleresimit, në kuadër të procesit të rivleresimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Është ashpërsuar politika penale dhe të masave të sigurimit në lidhje me veprën penale të dhunës në familje, krimit kundër jetës, armëmbajtjes pa leje, personave përsëritës në krim.

Është ndjekur një politikë e butë penale ndaj personave që kanë kryer vepra penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore.

- **INFORMACION MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Gjatë vitit 2019, në punën e përditshme të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, kanë gjetur zbatim Rekomandimet Prioritare “Në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019”, miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ka patur një bashkëpunim të frytshëm me Policinë e Shtetit dhe me agjensitë e tjera ligjzbatuese. Ka patur një rritje të hetimeve proaktive dhe përdorim të teknikave speciale të hetimit, përmirësim të cilësisë së hetimit.

Lidhur me përmirësimin e cilësisë së hetimeve nëpërmjet rritjes së numrit të procedimeve penale/të pandehurve, në hetim janë regjistruar 19 procedime penale të reja për nenin 287 të K.Penal, nga të cilat janë dërguar 5 procedime për gjykim me 12 persona të pandehur në total dhe 2 të dënuar. Nga këto një çështje ka përfunduar me vendim pafajësie një çështje penale, për të cilën është ushtruar ankim nga prokurori; ndërsa për çështje tjetër penale është dhënë vendim fajësie nga Gjykata, për të cilën është bërë ankim nga i pandehuri.

Për një procedim penal nga ana e Prokurorisë Fier është vendosur sekuestro preventive.

Gjithashtu janë në proces verifikimi 60 verifikime pasurore që ndiqen sipas ligjit Anti Mafia.

Për vitin 2019, janë regjistruar 67 procedime penale për nenin 283 të K.Penal, nga të cilat 27 procedime janë dërguar për gjykim. Janë dhënë 29 vendime fajësie (*përfshirë dhe çështjet e mbartura në gjykim*) dhe një vendim pafajësie, për të cilat janë bërë në total 20 ankime në Gjykatën e Apelit Vlorë.



Në përputhje me këto rekomandime janë vlerësuar drejt kushtet dhe kriteret e vendosjes së masave të sigurimit, kërkesat për masat e dënimit në gjykim.

Eshtë ashpërsuar politika e dënimit për veprën penale të dhunës në familje, e cila gjithsesi mbetet një fenomen i përhapur. Eshtë rritur vëmendja e prokurorëve në hetimin ndaj subjekteve që bëjnë evasion fiskal.

- **INFORMACION STATISTIKOR MBI CESHTJET PENALE QË LIDHEN ME PROCESIN E VERIFIKIMIT TË INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN, OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE.**

Në vitin 2019, nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në Prokurorinë Fier nuk është referuar asnjë kallelzim penal.

Në vitin 2019, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Prokurorinë Fier janë referuar 2 kallëzime penale.

Nga Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme, për vitin 2019 janë referuar 2 kallëzime penale, të cilat lidhen me procesin e Verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emerohen ose Ushtrojne Funkcione Publike.

*Tabela e mëposhtme tregon ecurinë e ketyre kallëzimeve.*

	<b>KALLËZIME</b>		<b>REGJISTRUAR PROÇEDIM</b>	<b>MËNYRA E PËRFUNDIMIT</b>
<b>ILDKP</b>	<b>0</b>	<b>NENI</b>		
<b>KLSH</b>	<b>2</b>	<b>258, 248</b>	<b>2</b>	<b>1 TRANSFERUAR SPAK, 1 KËRKESË PËR PUSHIM</b>
<b>DAP</b>	<b>2</b>	<b>190/1</b>	<b>2 ME 2 TË PANDEHUR</b>	<b>2 DËRGUAR GJYQIT</b>

- **TË DHËNAT PËR TEMAT DHE NUMRIN E TRAJNIMEVE TË PROKURORËVE DHE OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE APO TË PËRBASHKËTA ME POLICINË E SHTETIT**

Në lidhje me temat dhe numrin e trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore për vitin 2019, të dhënat paraqiten si më poshtë vijon:

Prokurorët:

**Violeta Shkurta ka marrë pjesë në 6 trajnime me tema:**

E drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së, Krimi kibernetik, Viktima dhe procesi penal, trajnim për Ligjin Antimafia, Pastrimi i produkteve të veprës penale, Trajnim rajonal për hetimin dhe ndjekjen penale të trafikimit të drogës, si edhe takimi e temë “Prezantimi i Raportit për Bashkëpunimin Prokurori dhe Polici Gjyqësore”.

Ka marrë pjesë në trajnimin “Forcimin e Marrëdhënieve/Team Building” organizuar nga Projekti European IPA 2017.

**Ervisa Hyka ka marrë pjesë në 5 trajnime me tema:**

Investigimi i rasteve që lidhen me sigurinë e gazetarëve.

Trajnimi “*Hetimi i rasteve të korrupsionit – Mekanizmat inovative dhe mjetet*”.

Zbatimi i ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 (Ligji Antimafia) dhe ristë e tij.

E Drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së.

Zbatimi i ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe ristë e tij.

**Genci Mane ka marrë pjesë në 7 trajnime:** “E drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së Gj.E.D.Nj”, “Trajnim rajonal për hetimin dhe ndjekjen penale të trafikimit të drogës”, “Provat në gjykimin penal”, “Aspekte formalo-juridike dhe të përmbajtjes, në këndvështrimin e doktrinës dhe jurisprudencës krahasuese të togfjalëshit “dyshim i arsyeshem, i bazuar në prova si kusht themelor në procesin e caktimit të masave të sigurimit”, Trajnim për Ligjin Antimafia”, “Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, në këndvështrim të ndryshimeve me ligjin nr.35/2017”.

**Elida Hoxhaj ka marrë pjesë në trajnime me temë** “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, E drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së , Viktima dhe procesi penal, Trajnim për Ligjin Antimafia, Krimi kibernetik.

**Aida Cakaj ka marrë pjesë në 4 trajnime:** Njoftimet dhe pavlefshmëria e tyre. Pastrimi i produkteve të veprës penale., Viktima dhe procesi penal, Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.

**Andi Pogace ka marrë pjesë në 6 trajnime** “Çështje të kuptimit juridiko-penal të provës indirekte (të tërthortë),”Metodat e reja dhe efektive për organizmin dhe zhvillimin e trajnimit”, “Prova me dëshmitarë në procesin penal dhe rëndësia e saj për të provuar faktet në procesin penal,Parashkrimi fitues përballë mënyrave të tjera origjinale të fitimit të pronësisë”, “Procedimet siguruese (Mbrojtja siguruese në përgjithësi, Sekuestrimi, procedimet e hetimit paraprak (sigurimi i padisë dhe i provës)”, “Natyra Juridike e largimit dhe përjashtimit të ortakut në SHPK”,

**Erind Reovica ka marrë pjesë në 2 trajnime:** “Trafikimi i narkotikëve”, “Prova shkencore dhe procesi penal”.

**Hysen Ajasllari ka marrë pjesë në 6 trajnime:** “Shkenca dhe Ligji” , “Drejtësia Penale për të Mitur, Standartet Ndërkombëtare Lidhur me Parimet e Drejtësisë Miqësore për të Miturit dhe Risitë e Legjislacionit Shqiptar”, “Trafikimi i Narkotikëve” ,“Provat në Gjykimin Penal” ,“Marrdheniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja” ,“Aplikimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit – masat e sigurimit, shmangia dhe arsyetimi ligjor i dënimeve penale” .

